

K. Ankimore nr. 1



Nr. 2024/1 Prot

Shkodër, me datë 03.01.2024

KËRKESË-ANKIMORE

- Objekti:**
1. Kundërshtim i Vendimit Nr.823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve “Për Miratimin e Raportit të Gjetjeve nga Auditimi i Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2021”, konkretisht pikës 96 të tij, për “Marrijen e masës administrative, për partinë politike “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike”.
 2. Shfuqizimin e pikës 96, të Vendimit Nr.823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve “Për Miratimin e Raportit të Gjetjeve nga Auditimi i Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2021”.
- Drejtuar:** Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve, Tiranë.
Adresa: “Rruga Ibrahim Rugova” nr. 4, Tirana
- Ankuesi:** Subjekti politik, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, përfaqësuar nga Nën/Kryetarja e Partisë Znj. Orjeta Shkambi
Adresa: Lagjia: “Skenderbeg”, Rruga: “Ing. Gjovalin Gjadri”, Shkodër.
Cel: 0695509462
- Baza Ligjore:**
1. Ligji nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i përditësuar.
 2. Udhëzimi nr.10, datë 21.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, dhe mënyrën e pagesës së audituesve”.
 3. Pika 106, e Vendimit Nr.823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve “Për Miratimin e Raportit të Gjetjeve nga Auditimi i Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2021”, e cila përcakton se: “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij”.



Referuar KAS!

Unë Orjeta Shkambi në cilësinë e Nën/Kryetares të partisë kam marrë dijeni me datë 23.12.2023 në lidhje me Vendimin Nr.823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve “Për Miratimin e Raportit të Gjetjeve nga Auditimi i Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2021”, i cili në pikën 96 të tij, përcakton “Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 1 000 000 (një million) lekë, sipas nenit 23/4, pika 2, të ligjit “Për Partitë Politike”, i përditësuar.

Referuar ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i përditësuar, konkretisht nenit 23/4, pika 2 e tij, përcaktohet shprehimisht se: “2. Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licensuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.”

Unë Orjeta Shkambi në cilësinë e Nën/Kryetares të partisë deklaroj se, me datë 30.05.2022 kam marrë njoftim në rrugë postare nga Z. Elton Tirana, Ekspert Kontabël i Regjistruar, i caktuar me detyrë nga KQZ-ja si auditues për kryerjen e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021.

Me të marrë njoftimin e kam telefonuar në numrin e telefonit të shënuar në njoftim +355 699 325 722 dhe kemi biseduar në lidhje me realizimin e auditimit të Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë. Disa ditë më vonë, Z. Elton Tirana në cilësinë e audituesit më ka telefonuar për ta orientuar drejt zyrës së selisë së partisë me qëllim për të realizuar auditimin, ku e kam pritur dhe jemi takuar në zyrën e selisë së partisë.

Gjatë takimit e kam njohur z. Elton Tirana dhe i kam vënë në dispozicion Pasqyrën Financiare të subjektit politik Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë për vitin kalendarik 2021 (për periudhën 1 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021) dhe Deklaratën e Partisë Popullore kristiandemokrate të Shqipërisë për audituesin ligjor Z. Elton Tirana. Po ashtu i jam përgjigjur për çdo pyetje që më është drejtuar.

Gjatë procesit të auditimit të subjektit politik të Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë për vitin kalendarik 2021, i kam deklaruar gojarisht dhe me shkrim audituesit ligjor Z. Elton Tirana se:

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë për vitin kalendarik 2021

- 1) Nuk ka pasur hyrje nga asnjë burim të ardhurash, si kuotat e anëtarësisë, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatorë vendas apo të huaj, hua, burime në natyrë apo kompensime shpenzimesh.



- 2) Nuk ka pasur burime materiale dhe financiare të trashëguara nga viti 2020.
- 3) Nuk ka realizuar asnjë blerje mallrash e shërbimesh për llogari të partisë nga operatorët tregtarë dhe individ dhe nuk ka bërë pagesa ndaj tyre.
- 4) Nuk ka pasur të punësuar dhe për rrjedhojë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore.
- 5) Nuk ka pasur kontrata për ambiente me qira apo huapërdorje.
- 6) Nuk ka hapur asnjë llogari bankare në bankat që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Në kushtet e mungesës së transaksioneve ekonomike dhe financiare ne kemi dorëzuar Pasqyrat Financiare me vlerë 0 (zero) që kërkohet nga KQZ-ja. Konfirmoj se këto të dhëna të deklaruara janë të sakta. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se subjektit politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë i është dorëhequr Kryetari i Partisë dhe vazhdon të jetë pa kryetar partie edhe sot, i mungon organizimi dhe funksionimi i saj, kjo parti nuk ka marrë pjesë në zgjedhje që nga viti 2017 dhe nuk ka zhvilluar aktivitet politik që prej asaj kohe.

Në Shtojcen Nr.1, faqe 16, pika 5, të Vendimit Nr.823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve, citohet se:

"5.Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, pasi audituesi ligjor ka kontaktuar me partinë politike nuk është dhënë asnjë dokumentacion tjetër vërtetues mbi bazën e të cilit janë përgatitur pasqyrat financiare të partisë politike. Gjithashtu vetë partia politike ka informuar se nuk është regjistruar në organet e tatimeve, si detyrim i kërkuar nga ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar."

Për sa më sipër del qartë se, subjekti politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë në zbatim të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 *"Për Partitë Politike"*, i përditësuar. ka bashkëpunuar me audituesin ligjor Z. Elton Tirana, i autorizuar nga KQZ-ja për realizimin e auditimit të detyrueshëm të partive politike, për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021, duke i vënë në dispozicion Pasqyrën Financiare të subjektit politik PPKDSH për vitin kalendarik 2021(për periudhën 1 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021) dhe Deklaratën e Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë për audituesin ligjor Z. Elton Tirana. Po ashtu, përfaqësuesi i kësaj partie i është përgjigjur për çdo pyetje që audituesi ligjor i ka drejtuar.

Në lidhje me pretendimin e shënuar në raportin e gjetjeve nga audituesi ligjor se *subjekti politik PPKDSH, nuk ka dhënë asnjë dokumentacion tjetër vërtetues mbi bazën e të cilit janë përgatitur pasqyrat financiare të partisë politike, i bëjmë me dije Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve se subjekti politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet politik apo financiar që prej vitit 2017, për rrjedhojë nuk ka disponuar asnjë dokumentacion tjetër, përveç Pasqyrave Financiare me vlerë 0 (zero) dhe Deklaratës të Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë për audituesin ligjor Z. Elton Tirana, të cilat ia ka dorëzuar këtij të fundit.*

Gjithashtu, theksoj se subjekti politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, nuk ka marrë asnjëherë që nga themelimi i saj e deri më sot asnjë qindarkë financim nga buxheti i shtetit.

Në lidhje me pretendimin tjetër të shënuar në raportin e gjetjeve nga audituesi ligjor se subjekti politik PPKDSH, nuk është regjistruar në organet e tatimeve, si detyrim i kërkuar nga ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar."

Sjellim në vëmendje të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, se bazuar në nenin 23/1, pika 4, të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i përditësuar, parashikohet se:

"4. Çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi."

Duke qenë se subjekti politik PPKDSH, nuk ka kryer asnjë shpenzim dhe nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga asnjë burim financiar që prej vitit 2017(nuk ka zhvilluar aktivitet politik), ka qenë pasive dhe për rrjedhojë nuk është regjistruar në organet tatimore.

Për sa kemi parashtruar më lart në këtë kërkesë-ankimore del qartë se subjekti politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë ka bashkëpunuar me audituesin ligjor Z. Elton Tirana, i autorizuar nga KQZ-ja për realizimin e auditimit të detyrueshëm të partive politike, për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021, duke i vënë në dispozicion Pasqyrën Financiare të subjektit politik PPKDSH për vitin kalendarik 2021(për periudhën 1 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021) dhe Deklaratën e Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë për audituesin ligjor Z. Elton Tirana, si dhe duke iu përgjigjur për çdo pyetje që audituesi ligjor i ka drejtuar, siç ju kemi cituar më lart, duke respektuar ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i përditësuar.

Në këto rrethana, në zbatim të nenit 23/4, pika 2 të ligjit "Për Partitë Politike", i përditësuar, i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve: **Shfuqizimin e pikës 96, të Vendimit Nr.823, datë 07.12.2023 të Komisionit Qendror (Shtetëror) të Zgjedhjeve "Për Miratimin e Raportit të Gjetjeve nga Auditimi i Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2021" dhe heqjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", me gjobë në vlerën 1 000 000 (një million) lekë.**

Ankuesi:

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë,
përfaqësuar nga
Nën/Kryetarja e Partisë Znj. Orjeta Shkambi



Shkodër, me datë 03.06.2022

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë

përfaqësuar nga Nën/Kryetarja e Partisë Znj. Orjeta Shkambi

Adresa: Lagjia: "Skenderbeg", Rruga: "Ing. Gjovalin Gjadri", Shkodër. Cel: 0695509462

Lënda: Deklarim i Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe ët shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021.


Për audituesin ligjor:

Z. Elton Tirana, Ekspert Kontabël i Regjistruar, i caktuar nga KQZ-ja për kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe ët shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021.

Kjo deklaratë jepet në përgjigje të njoftimit tuaj të datës 26.05.2022, njoftim për të cilin kam marrë dijeni në rrugë postare me datë 30.05.2022, për informacion në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021, nga Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë.

Unë Orjeta Shkambi në cilësinë e Nën/Kryetares së PPKDSH, deklaroj me përgjegjësi të plotë, se: Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë për vitin kalendarik 2021 (1 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021):

- 1) Nuk ka pasur hyrje nga asnjë burim të ardhurash, si kuotat e anëtarësisë, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatorë vendas apo të huaj, hua, burime në natyrë apo kompensime shpenzimesh.
- 2) Nuk ka pasur burime materiale dhe financiare të trashëguara nga viti 2020.
- 3) Nuk ka realizuar asnjë blerje mallrash e shërbimesh për llogari të partisë nga operatorët tregtarë dhe individ dhe nuk ka bërë pagesa ndaj tyre.
- 4) Nuk ka pasur të punësuar dhe për rrjedhojë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore.
- 5) Nuk ka pasur kontrata për ambiente me qira apo huapërdorje.
- 6) Nuk ka hapur asnjë llogari bankare në bankat që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.



Në kushtet e mungesës së transaksioneve ekonomike dhe financiare ne kemi dorëzuar Pasqyrat Financiare me vlerë 0 (zero) që kërkohet nga KQZ-ja.

Konfirmoj se këto të dhëna të deklaruara janë të sakta.

Kjo vërtetohet edhe nga fakti se subjektit politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë i është dorëhequr Kryetari i Partisë dhe vazhdon të jetë pa kryetar partie edhe sot, i mungon organizimi dhe funksionimi i saj, kjo parti nuk ka marrë pjesë në zgjedhje që nga viti 2017 dhe nuk ka zhvilluar aktivitet politik që prej asaj kohe.

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë,

përfaqësuar nga

Nën/Kryetarja e Partisë Znj. Orjeta Shkambi



Emërtimi dhe Forma ligjore PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË
NIPT - i _____
Adresa e selisë Lagja: "Skenderbeg";Rr." Ing.Gjovalin Giadri".Shkoder
Data e krijimit 18/5/2012
Nr.i Vendimit të Gjykatës 5096 Nr. i Regjistrimit 11691
Veprimtaria Kryesore Parti Politike

PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2021

Pasqyra e Financave janë individuale _____ x
Pasqyra e Financave janë të konsoliduara _____
Pasqyra e Financave janë të shprehura në _____ Leke
Pasqyra e Financave janë të rrumbullakosura në lek _____ x

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare Nga 01.01.2021
Deri 31.12.2021
Data e mbvlljes së Pasqyrave Financiare 14/3/2022

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI

NIKOLIN SHPATAJ
14/3/2022



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	A K T I V E T	Shënime	2021	2020
	Aktivitet afatshkurtra			
	▶ Aktivitet monetare			
	1 Banka		0	0
	2 Arka		0	0
	▶ Investime			
	1 Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit		0	0
	2 Aksionet e veta		0	0
	3 Të tjera financiare		0	0
	▶ Të drejta të arkëtueshme			
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit		0	0
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
	4 Të tjera		0	0
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar		0	0
	▶ Inventarët			
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		0	0
	2 Prodhime në proces dhe gjysmëprodukte		0	0
	3 Produkte të gatshme		0	0
	4 Mallra		0	0
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje dhe majmëri)		0	0
	6 AAGJM të mbajtura për shitje		0	0
	7 Parapagime për inventar		0	0
	▶ Shpenzime të shtyra		0	0
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		0	0
I	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA		0	0
	AKTIVET AFATGJATA			
	▶ Aktive financiare			
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
	4 Tituj të huadhënies në njësië ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		0	0
	6 Tituj të tjerë të huadhënies		0	0
	▶ Aktivitet materiale			
	1 Toka dhe ndërtesa		0	0

	2 Impiante dhe makineri		0	0
	3 Të tjera instalime dhe paisje		0	0
	4 Parapagime për aktive materiale dhe proces		0	0
	▶ Aktivet biologjike		0	0
	▶ Aktive jo materiale:			
	1 Konkencione,patenta,licenca,marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		0	0
	2 Emri i Mirë		0	0
	3 Parapagime për AAJM		0	0
	▶ Aktive tatimore të shtyra		0	0
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar		0	0
II	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA		0	0
	AKTIVE TOTALE		0	0

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI

Nikolin Shpataj
15/11



Pasyra e Pozicionit Financiar(Bilanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënime	2021	2020
	▶ Detyrime afatshkurtra			
1	Titujt e huamarrjes		0	0
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		0	0
3	Arkëtime në avancë për porosi		0	0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		0	0
5	Dëftesa të pagueshme		0	0
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit		0	0
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore		0	0
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore		0	0
10	Të tjera të pagueshme/Hua të tjera		0	0
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
	▶ Të ardhura të shtyra		0	0
	▶ Provizione		0	0
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		0	0
	▶ Detyrime afatgjata:			
1	Titujt e huamarrjes		0	0
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		0	0
3	Arkëtimet në avancë për porosi		0	0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		0	0
5	Dëftesa të pagueshme		0	0
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit		0	0
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
8	Të tjera të pagueshme		0	0
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
	▶ Të ardhura të shtyra		0	0
	▶ Provizione:			
1	Provizione për pensionet		0	0
2	Provizione të tjera		0	0
	▶ Detyrime tatimore të shtyra		0	0
	Totali i Detyrimeve Afatgjata		0	0
	DETYRIMET TOTALE		0	0
	▶ Kapitali dhe Rezervat		0	0
	▶ Kapitali i Nënshkruar		0	0
	▶ Primi i lidhur me kapitalin		0	0
	▶ Rezerva rivlerësimi		0	0

► Rezerva të tjera		0	0
1 Rezerva ligjore		0	0
2 Rezerva statutore		0	0
3 Rezerva të tjera		0	
► Fitimi i pashpërndarë		0	0
► Fitim / Humbja e Vitit		0	0
Totali i Kapitalit		0	0
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		0	0

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI




FONDET E PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA GJATË VITIT 2021

Nr	Përshkrimi sipas natyrës	2021	2020
1	Fondet e mara		
		0	0
1.1	Nga fondet publike	0	0
1.2	Nga kuotat e anëtarëve të partisë	0	0
1.3	Donacionet e përfituara në vlerë monetare	0	0
1.4	Donacionet e përfituar në sende dhe shërbime të vlerësuara me vlerë tregu	0	0
1.5	Përfitime nga reklama televizive	0	0
1	Shuma totale e fondeve të fituara	0	0
2	Shpenzime të kryera për vitin 2019	0	0
2.1	Shpenzimet e punonjësve të administratës	0	0
2.1.1	Pagat e punonjësve	0	0
2.1.2	Sigurimet shoqërore shëndetsore	0	0
2.1.3	Udhëtim dhe dieta	0	0
2.2	Marrje salle me qera	0	0
2.3	Spote publicitare	0	0
2.3.1		0	0
2.4	Konzulenca të ndryshme	0	0
2.4.1		0	0
2.4.2		0	0
2.5	Shpenzime telefonike	0	0
2.5.1	- Telekom < Vodafone etj	0	0
2.5.2	- Albtelekom	0	0
2.6	Postera, fletëvolante, fletëpalosje, reklama, banderola	0	0
2.6.1		0	0
2.6.2		0	0
2.7	Shpenzime kancelari	0	0
2.7.1	Kancelari letër		
2.7.2		0	0
2.7.3		0	0

2.7.4			0	0
2.8	SMS Promocionale		0	0
2.9	Karburante			
2.1	Energji elektrike		0	0
2	Totali i shpenzimeve		0	0

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI

06/11/2022
NSH



PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË

Metoda direkte


Për vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2021

	2021	2020
Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit		
Paratë e arkëtuara nga kuotat		
Paratë e donacionet		
Paratë e shpenzuara	0	0
Interesi i paguar		
Tatim fitimi i paguar		
MM neto nga veprimtaria e shfrytëzimit	0	0
Fluksi monetar nga veprimtaria investuese		
Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		
Blerja e aktiviteteve afatgjata materiale		
Të ardhura nga shitja e paisjeve		0
Interes i arkëtuar	0	
Dividentët e arkëtuar		
MM neto të përdorura në veprimtarinë investuese	0	0
Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
Të ardhura nga emetimet e kapitalit aksioner		
Të ardhura nga huamarrje afatgjata		
Pagesat e detyrimeve të qerasë financiare		0
Dividentët e paguar	0	
MM neto të përdorur në veprimtarinë financiare	0	0
Rritja / rënia neto e mjeteve monetare	0	0
Mjete monetare në fillim të periudhës	0	0
Mjete monetare në fund të periudhës kontabile	0	0

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

NIKOLIN SHPATAJ



N/KRYETARI I PARTISË

ORJETA SHKAMBI



PASQYRAT FINANCIARE 2021

SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE

Politikat Kontabele

Për hartimin e pasqyrave financiare për periudhë 01.01.2021 – 31.12.2021 është mbështetur në Standartet Kombëtare Të Kontabilitetit për bliancet e OJF. Të ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen sipas natyrës dhe pasyra është hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë paraqitur me vlerën e drejtë.

Nuk ka llogari bankare.

Gjatë vitit 2020 nuk ka kryer as një arkëtim ose pagesë.

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

NIKOLIN SHPATAJ



N/KRYETARI I PARTISË

ORJETA SHKAMBI





Tiranë

26/05/2022

Kontakt:

Elton Tirana

E-mail:

elton.tirana@studiotirana.com

Cel: +355 699 325 722

Drejtuar : "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë"

Në vëmendje të: Z. Pjerin Kodraçaj

Objekti: Njoftim

Me anë të kësaj shkrese, unë i nënshkruari, z. Elton Tirana, auditues ligjor me numër liçense 257, datë 27/08/2012 njoftoj z. Pjerin Kodraçaj, në cilësinë e kryetarit të "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë" se bazuar në kontratën e shërbimit nr. Prot 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, i përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj me mision

"Kryerja e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021",

kërkoj nga ana juaj të pajisem me informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës së caktuar më sipër.

Në mungesë të informacioneve në lidhje me personin përgjegjës kontakt për partinë tuaj po ju dërgoj këtë shkresë informuese në adresën deklaruar nga ana juaj si më poshtë:

"Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", Lagjia "Shkëndërbeg", rr. "Ing.Gjovalin Gjadri", Shkodër

Në pritje të një përgjigje nga ana juaj ju vendos në dispozicion disa kanale komunikimi:

1. Cel: +355 699 325 722
2. E-mail: elton.tirana@studiotirana.com
3. Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Medar Shtylla, Kompleksi KIKA 1, Nd. 47, H. 23, Ap. 8

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Elton Tirana

